



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES



MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje

Procesverbal nga mbledhja e I- rë e KKSBB-së e mbajtur më 23 prill (e mërkurë) 2026, në ora 10:00, në Sallën e Vogël të Ndërtesës së Komunës.

Të pranishëm në mbledhje ishin: Adnan Ademi (Nënkryetar i Komunës së Shtimes), Haxhi Behluli (Komandant i Policisë në Shtime), Skender Baftiu (K.B.I), Agron Çitaku (FSK), Arsim Qerimi (FSK), Fatmir Tahiri (FSK), Muhamet Mehmeti (ZKKK) Lulzim Sahiti (DKA), Skënder Dauti (DSHP), Lirim Halimi (Kryqi i Kuq i Kosovës), Muhadin Halili (GVSP), Reshat Gashi (ZBGJ-ZKO), Sabrie Veliu (KPK), Vlora Hyseni (Z.I), Gentiana Mehmeti (Zyra e kryetarit), Admire Selmani (Z.I), Teuta Mustafa (Z.I) .

Pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, nënkryetari Ademi hapi mbledhjen e parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes. Pasi konfirmoi se të gjithë të pranishmit kanë marrë paraprakisht rendin e ditës, ai i prezantoi edhe një herë pikat e rendit të ditës.

Adnan Ademi: Për sot i kemi paraparë këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2025
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës
3. Zbatimi i masave për siguri në punë
4. Shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në lagjet e fshatrave dhe qytetit
5. Të ndryshme

Të gjithë anëtarët e pranishëm u pajtuan dhe votuan unanimit për procesverbalin dhe për pikat e rendit të ditës. Pasi nuk pati diskutime për procesverbalin, unanimit kaloi edhe procesverbali.

Për pikën e dytë të rendit të ditës fjala iu dha komandantit të stacionit policor në Shtime, z. Haxhi Behlulit.

Haxhi Behluli: Faleminderit nënkryetar, faleminderit prej të gjithëve. Unë ju përshëndes të gjithëve, shpresoj që jeni mirë. Po du edhe të shpreh ngushëllime për kolegën tuaj Yllkën, që ka qenë edhe pjesë e drejtorisë së komunës, kështu që ngushëllime për të gjithë stafin. Në pika të shkurtra, unë po mundohem të jap një raport të sigurisë, duke e marrë parasysh që tani jemi në muajin e katërt, realisht unë i kam ndarë statistikën për tre muajt e parë e deri më datën 20 të këtij muaji, dhe do t'i referohem kësaj analize. Domethënë duke e marrë parasysh edhe shqyrtimin e statistikave që i kemi në bazë të rasteve që i kemi pranuar dhe të situatave të ndryshme si incidente apo raste të ndryshme aksidente trafiku, në përgjithësi është një gjendje që realisht në bazë të veprave që i kemi pranuar nuk e kanë prishur rendin, pra nuk ndikojnë në sigurinë e përgjithshme, por ka qenë një përkufizim i rasteve, më shumë individuale e herë herë ka prekur edhe shoqërinë, pra ka pasur raste goxha të ndjeshme, por realisht nuk kemi grupe kriminale, terroriste apo në këtë rast vrasje apo grabitje që janë prej veprave më të rënda. Së bashku kështu edhe si komunë e Shtimes, në rajonin tonë të përgjegjësisë, është një nivel i qetë dhe siguria është në nivel të duhur. Rastet e tre mujorit janë raste të karakterit të cilat nuk e cenojnë sigurinë e përgjithshme, ndonëse janë raste penale dhe incidente që kanë ndikuar në familje, i kisha përmend dy rastet e fundit që kanë ndodhur dhe që kanë ndikuar edhe në shoqëri, rasti në Godanc, një humbje e jetës, që është ende rasti duke u hetuar, megjithatë janë të përfshira edhe hetimet për krime të rënda, dhe rasti tjetër për siguri në punë që ka humbur jetën një qytetar i Shtimes, që ka qenë në rrethana të njohura në vendin e punës. Domethënë janë dy raste që kanë pësuar me fatalitet dy persona, por jo prej rasteve kriminale. Nëse i bëjmë krahasimet e tre mujorit të vitit të kaluar, me tre mujorin e këtij viti, në vitin e kaluar i kemi pasur 141 raste, ndërsa 113 i kemi në këtë tre mujor. Prej 131 rasteve që i kemi në vitin 2026, 32 janë regjistruar si aksident trafiku, me dëme të vogla materiale, por rastet më të rënda më lëndimë më të rënda i merr trafiku rajonal, por realisht nuk kemi pasur fatalitet. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar dhe hetuar raste penale, incidente dhe janë dërguar shumica në prokurori të zbuluara. Ka prej rasteve që ndërliken me veprime kriminale si dhuna në familje, lëndime trupore, dëmtim i pasurisë, vjedhje, posedim i armëve, posedim i drogave. Karakteri i veprave paraqitet si në tabelën në vijim:

01.01.2025 – 2026 - 20.04.2025/2026		
	2025	2026
Kanosje	12	4
Ngacmim	2	0
Sulm	3	4
Lëndim i lehtë trupor	11	3
Lëndim i rëndë trupor	1	0
Dëmdim prone	0	5
Grabitje	0	0
Shpërdorim i pasurisë së huaj	1	1
Dhunë në familje	12	10
Vjedhje	12	10
Vjedhje e rëndë	11	9
Vjedhje e pyllit	0	2
Tentim vjedhje	2	6
Mashtrim	1	0
Posedim i substancave narkotike	5	7
Hyrje në sistemin kompjuterik	0	0
Armëmbajtje pa leje	5	7
Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	3	1
Sulm – Kanosje ndaj personit zyrtar	1	0
Dhunim	1	0
Sulm seksual / Ngacmim seksual	1	0
Incident zjarri / Zjarrvënie	1	0
Gjueti e kundërligjshme	1	0
Monedhë e dyshuar për falsifikim	6	2
Ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit	1	0
Keqtrajtim i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit	1	1
Heqje e pajisjeve mbrojtëse / Rrezikim në vendin e punës	1	4
Falsifikim i dokumenteve	1	0
Privim i kundërligjshëm nga liria	1	0
Hetim mbi vdekjen	0	2
Marrje në posedim e pasurisë së luajtshme	1	1
Shantazh	1	1
Lajmërim apo deklarim i rremë	0	1
Aksident trafiku	43	32
Gjithsej raste	141	113

Pra, në këtë tabelë i përmenda disa prej rasteve më me ndikim, ndërsa pjesa tjetër, hetimi dhe zbulimi i disa rasteve që ndërlidhen me vepra penale ka pasur rezultat në zbulimin e disa rasteve, më shumë të vjedhjeve, dhe të rasteve të tjera që shpeshherë i kemi me persona të njohur. Te dhuna në familje kemi rënie të rasteve, megjithatë këto janë raste me prioritet, brenda 24 orëve, domethënë dhuna në familje trajtohet shumë më shpejt dhe e merr dënimin e personave që përfshihen në këtë drejtim. Te zbatimi i planeve operative, është më rëndësi të jeni në dijeni që sezona verore gati tash fillon me u aplikuar. Kjo sezonë përfshin shumë kapituj që realisht aty hynë gati të gjitha: drogat, muzikat e larta, mërgimtarët që na vijnë, parandalimi i zhurmave, i armëve dhe i dukurive të tjera negative, në këtë plan faktikisht kemi filluar me punë. Siguria në trafik gjithsesi është aktive; garat e shpjetësisë, motoçikletat. Siguria në shkollë ka funksionuar edhe në këtë tre muaj, që në bashkëpunim edhe me drejtorinë e arsimit kemi mbajtur ligjëratat për parandalimin e dukurive negative. Për sigurinë në komunikacion janë shqiptuar 926 gjoba vetëm gjatë këtyre tre muajve. Kryesisht janë për parkingje, për shpejtësi, ka patent shoferë të konfiskuar, vetura të konfiskuara që janë me afat 1 muaj ndalesë për vozitje të veturës. Rekomandimet që jepen janë stabilizimi, shtimi i kamerave të sigurisë, këto janë si kërkesa realisht që ne bashkë me i trajtojmë në të ardhmen që me u mundu me i dhanë karakter më të mirë sigurisë së përgjithshme në rajonin tonë. Ne veç i kemi kamerat funksionale, por është e domosdoshme rregullimi dhe përmirësimi i gjendjes së kamerave ekzistuese, pastaj vendosja e kamerave në fshatra, që është një çështje shumë me rëndësi nëse ne mund ta arrijmë së bashku me organet komunale, pra drejtorinë, dhe vendosja e disa shenjave të trafikut që luan rol të rëndësishëm për sigurinë në trafik. Të sigurohen vende për parkingje të veturave. Planifikimi dhe bashkëpunimi me institucione për izolimin apo strehimin e qenve endacakë. Ne si polici kemi pasur rastin ku në Belinc është dashur të intervenojmë duke e eliminuar një qen endacak që e ka rrezikuar një vajzë. Në anën tjetër edhe ne kemi përgjegjësi dhe duhet të veprojmë sipas ligjit sepse kemi institucionin qendror për mborjtjen e kafshëve, ne duhet të raportojmë sikur prokurorisë, ashtu edhe institucioneve tjera, por në këtë rast ka qenë kanosja direkte. Të ndryshohet gjendja e oborrit të shkollës fillore, siç e kemi diskutuar edhe më herët edhe me drejtorinë e arsimit, është me rëndësi që për sigurinë e nxënësve të bëhet një ndryshim të shkollës fillore. Në një pikë statike të policisë e kemi çdo herë, gjë që nuk e kemi obligative, por realisht ne rrimë aty rreth 1 orë. Por meqë tash edhe është koha e verës duhet të bëjmë thirrje që nxënësit të vijnë sa më shumë në këmbë me prindërit e tyre e jo me vetura. Ne e kemi diskutuar edhe më herët që hyrja e shkollës po bllokohet, tiketa shkruhet, por nganjëherë kjo si çështje nuk zgjidhet përmes dënimeve. Të monitorohet transporti i prindërve, të licensohen kombi-busët. Ne e dimë që disa prej tyre edhe nuk janë

të regjistruar në drejtori të arsimit që duhet t'i bartin ata nxënës, prindërit ju japin pagë mujore atyre që i bartin , por realisht ky është transport i parregullt. Ne kemi biseduar edhe me ata transportues, ata duhet të kenë shenjat, të jenë të regjistruar, të miratuar prej drejtorisë së arsimit e jo të veprojnë në mënyre disi ilegale. Të ketë kontrollë në lokale ushqimore, kafiteri, kioska, inspektimi i tyre për orarin, zhurmat , gjendjen e artikujve, pastërtisë dhe lejen përkatëse për të zhvilluar veprimtarinë, gjë të cilën e hasim shpeshherë edhe ne, por për këtë çështje kemi bashkëpunim me inspektorë dhe me drejtorië komunale. Koordinimi dhe bashkëpunimi institucional për raste kur kemi të bëjmë me problemet familjare, psiqike, faktikisht që në familje ne kemi raste kur ankohen edhe te ne. Është bërë një punë e mirë për disa persona, realisht për një person që është në shtëpinë e komunitetit , megjithatë ne jemi taku edhe me drejtorë të qendrave që të kemi një përkushtim më të madh për atë person që mos të lëvizë pa përcjellje. Ngritja e nivelit të sigurisë në shkolla nga drejtorië, mësimdhënësit dhe siguri i objektit të bëhet në bashkëpunim me stacionin policor, meqë ne veç e kemi një bashkëpunim të mirë me Lulin dhe me gjithë stafin siç e kemi cek që nxënësit për ne janë pikë e dobët dhe siguria te ta duhet të jetë përherë në nivelin më të lartë dhe jemi duke u munduar që ta ngrisim këtë mekanizëm të sigurisë. Dhe për fund, ruajtja e ambientit dhe menagjimi i mbeturinave që jemi duke funksionuar edhe në këtë lëmi bashkë si KKSB. Mua më erdh mirë që dje pasi ishte Dita e Tokës në kuadër të qeverisë ishin disa aktivitete si vendosja e disa gardianëve që do të punojnë në këtë drejtim. Ata si e kam kuptuar do të punojnë bashkë me policinë dhe bashkrisht ne të gjithë duhet të bëjmë thirrje në këtë drejtim dhe për ruajtjen e ambientit. Ndoshta pak e zgjata por u mundova që në pika të shkurtra të jap një raport për gjendjen aktuale. Faleminderit për vëmendje. Nëse keni ndonjë pyetje jam i gatshëm t'ju përgjigjem.

Lulzim Sahiti: Përshëndes të gjithë pjesëmarrësit e kësaj mbledhjeje të KKSB-së, njëherit e falënderoj komandantin e policisë për raportin e detajuar. Unë desha të ndërlihem vetëm te çështja e sigurisë së nxënësve te shkolla "Emin Duraku". Unë propozoj që ne si KKSB ta bëjmë një rekomandim te Drejtoria e Shërbimeve Publike që në pjesën prej stacionit të vjetër të policisë e deri tek qebaptorja, aty të jetë parking, meqenëse është edhe rruga e gjerë dhe ka hapësirë që të bëhen edhe vijat e bardha, jo të jetë parking për kohë të gjatë por vetëm sa t'i lënë nxënësit. Mendoj që ky projekt do t'ia lehtësonte shumë punën policisë. Gjithashtu, unë nuk e di si është statusi i stacionit të vjetër të policisë, ai përditë e më shumë është duke u shkatërruar, dhe mendoj që do t'ishte mirë të mbetej si monument historik sepse është objekt që daton nga viti 1925, edhe për këtë do të thoja që të jepnim një rekomandim që të merret nën

mbrojtje, sepse për ma tepër paraqet edhe rrezik nëse vjen çdo dite e duke u shkatërruar, por pse jo edhe të mbetet monument historik për t'i kujtuar të gjitha torturat dhe dhunën serbe që ka ndodhur aty para lufte dhe gjatë saj.

Haxhi Behluli: Faleminderit. Rekomandimi është shumë me vend për çështjen e parkingut, që aty të jetë një hapësirë që realisht do të na ndihmonte të gjithëve. Edhe sa i përket stacionit, ne vazhdimisht e kemi shqetësimin se mos ndodh diçka sepse ka mbetur një pjesë e lënë pas dore, por si objekt e kemi parasysh që me e siguru në të ardhmen dhe me e verifiku se kush duhet të jetë përgjegjës për atë pjesë sepse si polici ajo është në barrën tonë dhe që duhet të jetë një monument që duhet të ruhet. Kështu që e kemi parasysh dhe këtë kërkesë ne mund ta përcjellim edhe te zyrtarët policorë që të interesohen. Dua ta cek gjithashtu një rast që e kemi pasur dje dhe që neve na ka bërë të ndihemi mire ku një nxënës i shkollës profesionale i ka gjetur në rrugë 180 euro dhe pasi e kemi identifikuar personin të cilit i kanë humbur, atij i janë kthyer të hollat. Nxënësin e kemi falënderuar dhe ky gjest i mirë është shpërndarë edhe nëpër rrjetet sociale.

Adnan Ademi: Faleminderit. Atëherë Luli i pati dy rekomandime, dhe për njërin e dha sqarimin z. Behluli dhe për tjetrin rekomandim për DSHP që ajo pjesë të bëhet parking, ne mund ta rekomandojmë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të dalë të shohë se si është mundësia aty që të ngritet një tabelë vertikale apo horizontale në rrugë, dhe a ka hapësirë aty që të ketë parking veç sa të ndalet vetura që t'i zbret fëmijët dhe të vazhdojë tutje. Atëherë këtë rekomandim ne si KKSBB duhet ta hedhim në votim, sepse vetëm me votë mund të rekomandojmë drejtorisë së shërbimeve publike dhe ata pastaj i shohin mundësitë se çfarë mund të bëjnë. Kush është PËR që t'i rekomandojmë DSHP që rruga Anton Çetta të pjesa shkollës, pjesa në anën e majtë, të bëhet parking për veturat që i dërgojnë fëmijët në shkollë? Unanimisht i rekomandojmë Drejtorisë së Shërbimeve Publike propozimin në fjalë.

Tani kishim kaluar te pika tjetër e radhës : Zbatimi i masave për siguri në punë. Këtu e kemi shefin e mergjencave që ia kishim kaluar fjalën tek kjo pikë.

Skënder Dauti: Faleminderit! Meqë drejtori dhe as inspektorat nuk janë këtu, më duhet me marrë rolin e tyre meqenëse është duke u punuar në një dokument për vlerësimin e rrezikut për komunën e Shtimes. Ky dokument do të dërgohet në Agjencionin për Menaxhimin E Emergjencave dhe do të kthehet në kuvend për miratim. Në këtë dokument parashihen të gjitha rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për komunën e Shtimes dhe është para

finales. Sa i përket zbatimit të masave të sigurisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike bashkë me inspektoriatin që në mëngjes dalin në terren dhe inspektojnë situatën e ndërtimeve që bëhen në komunën e Shtimes, rreziqet, vazhdimisht kanë procesverbale dhe rasti i fundit që ndodhi, aksidenti në vendin e punës, me këtë rast është duke u marrë inspekcioni i punës. Kjo si çështje është shqetësuese edhe në nivel vendi, siç e keni parë edhe përmes medieve, janë duke u marrë masa. Sa i përket rreziqeve të tjera, siç ndodhi tërmeti i fundit para një muaji në regjionin e Ferizajt, afër Prevallës, ku intensiteti i dridhjes që mbi 4 shkallë të rihterit dhe hapi i parë i zyrës për mbrojtje dhe shpëtim dhe inspektoriatit ishte dalja në terren dhe vlerësimi i objekteve me lartësi mbi tetë kate dhe nuk është vërejtur që ka pasur plasaritje, d.m.th ndërtimet kanë qenë të nivelit të lartë. Edhe pse komuna e Shtimes sipas hartave seizmike, parashihet tërmet i shkallës së shtatë por jo epiqendër. Te inspektimi i masave të sigurisë, ne nuk kemi inspektor të punës por kemi inspektor të ndërtimit dhe të mjedisit. Por ne edhe si zyre edhe si drejtori e shërbimeve publike vazhdimisht jemi në terren dhe janë identifikuar të gjitha rreziqet që kanosen qoftë në komunikacion, qoftë afër ndërtimit të rrugëve, qoftë te objektet që paraqesin rrezik permanent. Së bashku edhe me Policinë e Kosovës me të cilën kemi bashkëpunim të mirëfiltë, jemi në nivelin më të mirë të mundshëm sa i përket çështjes së sigurisë.

Haxhi Behluli: Faleminderit Skënder që i paraqite këto informata. Desha të lidhem te pika për zbatimin e masave për siguri në punë, siç e tha edhe Skënderi që inspektorët veprojnë, por edhe ne si polici, duke e parë gjendjen e përgjithshme që realisht kohëve të fundit në nivel vendi ka pasur rritje të rasteve të personave që kanë humbur jetën në punë, dhe ne e kemi marrë seriozitetin në këtë drejtim, personalisht iu kam rekomanduar policëve që të bashkëpunojnë me inspektorë në disa raste. Këtu u ngrit shqetësimi sa që një banor para dy ditësh e përcillte një familjar të tijin që te ndërtesa ku po punonte në lartësi të madhe dhe në rrezikshmëri të lartë e lajmëroi policinë. Ne kemi pasur edhe një takim me zjarrfikësit, dhe kemi shtruar çështjen se sa janë ata të gatshëm dhe a kanë mjete të veprojnë në raste të zjarreve apo kur dikush lëndohet në punë në lartësi. Përfundimisht mendoj që duhet t'i shtojmë inspektimet në ndërtimet e larta që I kemi, masat e sigurisë sa mirren aty. Policia t'i bëjë fotografitë, ne tashmë veç e kemi një raport gati për disa ndërtime që binë në përgjegjësinë e investitorëve dhe pronarëve të firmave të ndërtimit. Edhe policia do punojë në këtë pikë me aq sa mund të marrë përgjegjësi duke marrë fotografi dhe duke dhënë rekomandime tek investitorët. Në këtë pikë unë them që duhet të angazhohemi të gjithë dhe të japim kontributin institucional të përbashkët.

Adnan Ademi: Faleminderit! Atëherë kalojmë në pikën tjetër që është shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në lagjet dhe fshatrat e qytetit. Megjithatë sa i përket kësaj pike, ish dashtë me qenë këtu Drejtoria e Shërbimeve Publike, por për shkak të rastit të drejtoreshës dje, disa janë familjarë e disa janë miq të saj dhe nuk janë ende në gjendje të kthehen në punë, por unë po i them nja dy-tri fjalë rreth kësaj çështjeje pasi që kam qenë në ngjarje që nga viti 2022. Shtrirja e rrjetit dhe ndriçimi publik në komunën e Shtimes pothuajse 70 a 80 përqind është përfshirë komuna e Shtimes dhe fshatrat. Ne kemi pasur edhe diskutime me policinë që ndriçimi publik nëpër fshatra ka ndikuar goxha shumë në sigurinë në fshatra dhe të mos ndodhin vjedhjet siç kanë ndodhur në të kaluarën. Megjithatë ne po mundohemi që edhe këtë vit të kemi projekte rreth ndriçimit publik, një kontratë e kemi në proces, dhe do të mundohemi që në të gjitha fshatrat dhe lagjet urbane të kemi ndriçim publik dhe aty ku ka probleme dhe defekte t'i evidentojmë dhe ta dërgojmë kompaninë e cila do ta marrë tani kontratën për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe të rregullohet çdo gjë. Besoj që komuna e Shtimes ka progres në këtë pikë. Kisha me u ndërlidh pak edhe te çështja e kamerave. Me vizitën tonë në natën e vitit të ri në stacionin policor e kemi parë si funksion edhe përmes monitorave. Besoj që ai trend i zhvillimit dhe instalimit të kamerave duhet me qenë ashtu si e kërkoi edhe komandanti, unë e mora si shënim dhe do të mundohem ta shtyj përpara. Unë e kam dhënë edhe një propozim që kamera të ketë edhe në këto pikat ku po hudhen mbeturinat, sidomos këto inerte, dhe përmes kamerave sekrete, që nuk shihen, ata akterë që po hudhin mbeturina dhe po e ndotin ambientin, në qytet e edhe nëpër fshatra, siç ndodh në Zvicër, të iu dërgohet dënimi në pliko bashkë me fotografi dhe kështu të ngritet vetëdija qytetare. Kjo është idea që besoj të realizohet nga ekzekutivi dhe nga DSHP. Nëse s'ka dikush diçka për të shtu kishim kaluar te pika tjetër që është pika e fundit "Të ndryshme" dhe këtu mund të diskutojmë për çështje të tjera.

Lirim Halimi: Përshëndetje për të gjithë. Jam Lirim Halimi, sekretar i Kryqit të Kuq dhe përfaqësues i organizatave joqeveritare në komunën e Shtimes. Disa çështje që i kemi diskutu para se me ardhë këtu, njëra që veç e përmendët, kamera në zonat ku hudhen mbeturinat për shkak se janë bërë shumë sidomos në disa zona malore që janë shumë të mira po u prishet imazhi nga mbeturinat. E kisha përshëndet si projekt pasi siç tha nënkryetari është duke u shqyrtu edhe prej ekzekutivit. Një problem tjetër për të cilin kemi diskutuar janë edhe qentë endacakë. Nuk e di a duhet të bëhet eliminimi i tyre apo duhet të shpallet ndonjë tender që dikush t'i marrë nën përkujdesje, por është çështje që duhet zgjidhur. Mbrëmë rastisa me qenë vonë në Shtime, e pashë sa qentë endacakë janë rrugëve dhe si i shpërndanin mbeturinat, që paraqet një problem për puntorët e pastrimit kur të vijnë t'i mbledhin. Te sektori i sigurisë, unë

desha t'ia bëj një pyetje komendantit të policisë se a ka ndonjë distancë të kufizuar ndërmjet mjeteve të rënda, sepse dje i pashë katër kamionë të mëdhenj njëri pas tjetrit që po vinin nga Belinci në Shtime dhe mendova nëse një vëture frenon aty, si mund të frenojnë kamionët aty pasi dihet që kanë peshë të madhe?! Por edhe afërsia e tyre me njëra tjetrën gjithashtu e pamundëson edhe tejkalimin në atë zonën dhe kështu ndikon edhe në trafik e në kolona.

Haxhi Behluli: Distanca te kamionët dallon. Nëse përpara tyre është duke lëviz një veturë në shpejtësi 40 km/h atëherë distanca mes tyre duhet të jetë 80m. Por te peshat e rënda distanca duhet të jetë edhe më e madhe për shkak se kur kanë peshë duhet të rrinë më larg njëri tjetrit. Ne policia e trafikut po e presim një aparat që është më i avancuar dhe që qytetari të jetë i njoftuar pse po dënohet, si po matet shpejtësia. Ne jemi në pritje të pajisjes që shërben për të matur distancën.

Lirim Halimi: Dua ta ngris edhe çështjen për personat me aftësi të kufizuara, për trotualet me nivelin zero. Ne tashmë po i shohim edhe disa persona që po drejtojnë mjete lëvizëse që mund t'i ngasin vetë, dhe gjendja e trotuareve po paraqet problem për ta, nuk po mund të ngjiten dhe shpesh edhe po dalin në rrugë. Nuk e di komuna a mund të merr masa aty ku mund të intervenohet që të përmirësohen. P.sh e kemi rastin te Viva ku një pjesë është lart 2 a 3 cm ndërsa pjesa tjetër është në nivelin zero dhe është problem nëse personi është vet. Një çështje tjetër që dua ta përmend janë edhe autolarjet përkaj rrugës, në Davidovc, në Shtime dhe në Belinc. Kam pa vet që për pak kanë shpëtua nga aksidentet duke ikur në anën e kundërt të rrugës nga presioni i ujit nga autolarja. Unë mendoj se do t'ishte mirë që për shkaqe sigurie këto biznese të jenë më larg rrugës. Dhe e fundit që dua ta diskutoj, është çështje për të cilën edhe kam studjuar, pasi jam agronom me profesion, është ndezja e zjarreve që bëhet te fushat bujqësore. Nuk e di nëse si komunë mund të shqiptohen gjoba për ata, sepse me këtë veprim dëmtohet shumë bujqësia, pasi ky veprim më së shumti ndodh pas korreve të grurit.

Skender Baftiu: Ju përshëndes të gjithëve. U diskutua mjaft shumë për sigurinë dhe ky është edhe qëllimi i takimit. Më pëlqeu shumë edhe mendimi i nënkryetarit për kamerat e sigurisë që të vendosen në ato vende ku vendosen mbeturinat. Nuk e di nëse komandanti është i njoftuar, por ne më datë 10 prill e patëm një vjedhje në xhaminë e Carralevës, fatkeqësisht edhe objektet fetare nuk po kursehen prej njerëzve të papërgjegjshëm, qoftë demolimin e tyre ose vjedhjen. Sot ne u njoftuam që janë vendosur disa kamera në xhami. Sikur të ishte vetëdija në nivelin si duhet të jetë, as hedhjen e mbeturinave as disa veprime të tjera ne nuk do t'i kishim bërë, kështu që këto masa duhet të mirren. Ajo që unë mund të them është që ne si Këshill i Bashkësisë

Islame në Shtime vazhdimisht mundohemi të japim kontributin tonë për siguri në Komunën tonë, sidomos me ligjërata të cilat i mbajmë në ditën e xhuma, dhe gjatë festave të ditëve të bajramit që kemi një numer më të madh, sidomos në fushën e edukimit dhe të ngritjes të vetëdijes dhe luftimit të dukurive negative, d.m.th dhunës në familje, lëndëve narkotike, por edhe fenomeneve që ne sot po përballemi si ndotja e ambientit, vetvrasjet, pastaj edhe dukurive të tjera, vazhdimisht ne mundohemi me përçu një mesazh të qartë. Në këtë aspekt jemi të gatshëm me bashkëpunu dhe kemi pasur bashkëpunim të mirë të vazhdueshëm edhe me komunën edhe me të gjitha institucionet e tjera. Në bazë të asaj që e dëgjova prej raportit të komandantit, siguria është më e mirë dhe ne jemi të kënaqur me këtë. Faleminderit!

Muhadin Halili: Unë isha lidh te tema e qenve endacakë. Ky është problem nacional dhe as komuna e Shtimes nuk mund t'i ikë këtij problemi. Ne si komunë për çdo vit kemi kontrata për matrikullim dhe kastrim të tyre, mirëpo jo të gjitha këto mund të bëhen te ky numër i qenve. Sa i përket eliminimit të tyre, ne nuk guxojmë sepse dënimi është tepër i madh nëse dikush eliminon një qen endacak. Është edhe shoqata për mbrojtjen e kafshëve me të cilët kemi bashkëpunim, mirëpo këtij problemi nuk po mund t'i ikim as ne.

Muhamet Mehmeti: Kemi biseduar edhe më herët për transportin e nxënësve. Me të vërtetë policia ndoshta ka marrë ndonjë hap, sepse unë kam vërejtur që në mjetet e transportit të nxënësve është një numër më i madh i nxënësve sesa është paraparë dhe nëse do të ndodhte një aksident kjo do të ishte fatale.

Haxhi Behluli: Ne kemi biseduar me shoferët e kombi busëve që bartin nxënësit dhe iu kemi rekomanduar që të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Arsimit.

Adnan Ademi: Dërgimi i fëmijëve në shkollë me vetura është bërë trend, unë apeloj që sidomos këto ditë meqë është moti i mirë dhe është aktivitet fizik, prindërit t'i dërgojnë fëmijët në shkollë në këmbë. Për fund unë ju kisha falënderu gjithsecilin, juve dhe institucionet që i përfaqësoni për punën që po e bëni jashtë këtij takimi dhe kontributin tuaj të vazhdueshëm. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora : 10:55







Procesmbajtëse:

Vlora Hyseni



Lista e pjesëmarrësve në mbledhjen e I-rë të KKSBB-së

Shtime, 23 prill 2026

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	Lirim Halimi	Kryqi i Kugj Kosovës	
2.	Agdon Çitaku	FSK	
3.	Arsim Gerimi	FSK	
4.	FATMIE TAHIRI	FSK	
5.	HAXHA BEHLULI	PODUA	
6.	SKENDER BARTIÇ	K. B. i.	
7.	Muhamet Mehmeti	ZKKK	
8.	Sabrie Velic	KPK	
9.	Shënolol Douka	D.S.P.	
10.	Muhadin Holli	B.V.S.B	
11.	Admir Selmani	Z. Informim	
12.	Tenta Mustafa	Zyra për informim	T. Mustafa
13.	Adnan Aleksi	Zyra kryetari t	
14.	Leht Goru	ZKO-ZDGO	
15.	Lulzim Sahiti	DKA	
16.	Gentiana Mehmeti	Zyra kryetarit	
17.	Vlora Hyseni	Zyra Informimit	
18.			